



QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

**RAPORT MBI PROCEDURAT E REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT
TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER
PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE
TË CIKLIT TË DYTË.**

VITI AKADEMIK 2024-2025

TIRANË

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE	1
RAPORT MBI PROCEDURAT E REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË.....	1
VITI AKADEMIK 2024-2025.....	1
Parathënie.....	3
Shënime për raportin.....	4
Kreu I.....	5
Procesi i Pranimeve në nivel kombëtar	5
Kreu II	6
Regjistrimet në nivel sistemi shkollimi (IAL publike/jopublike)	6
Kreu III.....	7
Shpërndarja e regjistrimeve në nivel IAL-je	7
Kreu IV.....	9
Regjistrimet sipas kuotave.....	9
Kreu V.....	12
Procesi i regjistrimeve në nivel program studimi	12
Kreu VI.....	15
Mesatarja e studentëve të regjistruar në IAL.....	15
Kreu VII.....	19
Cilësia e studentëve të regjistruar sipas gjinisë dhe urbanizimit	19
Kreu VIII.....	20
Shpërndarja e studentëve të regjistruar sipas intervaleve të notës mesatare sipas IAL	20
Kreu IX.....	27
Procesi i pranimit në programet e studimit të fushës mësuesi.....	27
Regjistrime në nivel kombëtar dhe sistemi shkollimi	27
Mesatarja e studentëve të regjistruar në IAL në programet e mësuesisë	29
Shpërndarja e studentëve të regjistruar sipas dendurive në segmentet e notës mesatare	32
Kreu X.....	38
Procesi i pranimit në programet e studimit të gjuhëve të huaja.	38
Regjistrime në nivel kombëtar dhe sistemi shkollimi	38
Mesatarja e studentëve të regjistruar në IAL në programet e gjuhëve të huaja	39
Shpërndarja e studentëve të regjistruar sipas dendurive në segmentet e notës mesatare	41

Parathënie

Ky raport ka për qëllim, jo vetëm të të pasqyrojë procesin e regjistrimeve në programet e ciklit të parë dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, për vitin akademik 2024-2025, në Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL), por edhe të orientojë më qartësisht vendimmarrësit në fushën e arsimit, maturantët dhe kandidatët për studentë, gjatë përzgjedhjes së tyre për programet e studimit që ofrohen nga Institucionet e Arsimit të Lartë, IAL-të publike dhe jopublike, në hartimin e strategjive më të mira për përmirësimin e kurrikulave dhe programeve të reja të studimeve, për informimin e maturantëve dhe kandidatëve rreth programeve të studimit që ofrojnë, si dhe orientimin e tyre në tregun e punës në të ardhmen.

Gjithashtu, synohet një ndërgjegjësim më i mirë i kandidatëve për student, për t'u fokusuar më mirë në ato programe studimi, ku ata mund të arrijnë potencialin e tyre maksimal dhe ku kanë më shumë mundësi të pranohen.

Meqenëse kriteret e pranimit, të vendosura nga IAL-të, mbështeten kryesisht në arritjet e maturantëve dhe kandidatëve në arsimin e mesëm të lartë, si dhe duke qenë ky filtri kryesor hyrës në IAL, mund të themi se, tërheqja e studentëve cilësorë është një faktor i rëndësishëm, që ndikon edhe cilësinë në vijueshmërinë e studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë.

Ky material jep informacion mbi studentët e pranuar në IAL, si edhe nivelin e studentëve hyrës sipas kriterit të notës mesatare. Informacioni është i organizuar në mënyrë të tillë që bën të mundur, jo vetëm njohjen e cilësisë të studentëve të pranuar në nivel kombëtar, por edhe në nivel IAL-je dhe programi studimi.

Gjithashtu, ky raport bën edhe një pasqyrim të procesit të pranimeve për vitin akademik 2024-2025 për programet e studimit, të cilat mund të profilizohen në mësuesi si dhe në programet e gjuhëve të huaja.

Shënime për raportin

Informacioni statistikor i këtij raporti është bazuar në databazën e të dhënave, të krijuar nga QSHA për:

- Realizimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2024.
- Mbledhjen e të dhënave për arsimin e mesëm të lartë nga shkollat dhe përllogaritjen e notës mesatare sipas VKM Nr. 436 , date 03.06.2020 i ndryshuar , për çdo maturant/kandidat aplikues.
- Kuotat e verifikuara dhe të certifikuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për kategorinë shqiptarë brenda vendit.
- Regjistrimet e studentëve në portalin U-Albania për vitin akademik 2024-2025 (cikli i parë i studimeve, për kategorinë shqiptarë brenda vendit).

Maturantët dhe kandidatët aplikuan në Portalin U-Albania, në tre raunde aplikimi, duke përzgjedhur deri në 7 preferenca, si dhe kryen regjistrimin në tre raunde pasuese në Portalin U-Albania, për pranimet në ciklin e parë të studimeve, të vitit akademik 2024-2025.

Vëmë në dukje se, në tri vitet akademike paraardhëse 2022-2023, 2023-2024 dhe 2024-2025, mbështetur në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave, u përcaktua si kriter aplikimi e pranimi në Institucionet e Arsimit të Lartë, në programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të ciklit të dytë, nota mesatare minimale 6.5. Gjithashtu, për programet e studimit, të cilat profilizohen në mësuesi, nota mesatare minimale 7.5. Kjo notë është përllogaritur si mesatare aritmetike e thjeshtë e dy treguesve:

1. Mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit të arsimit të mesëm të lartë.
2. Mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të Maturës Shtetërore.

Në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 436, datë 03.06.2020 i ndryshuar, nisur nga viti 2019-2020 dhe këtë vit akademik 2024-2025, u përcaktua si kriter aplikimi e pranimi në Institucionet e Arsimit të Lartë, në programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të ciklit të dytë, nota mesatare minimale 6.5 . Gjithashtu, për programet e studimit, të cilat profilizohen në mësuesi, nota mesatare minimale është 7.5.

Në ndryshim me vitet paraardhëse, për vitin akademik 2024-2025, u përcaktua me Vendim për programet e studimit të gjuhëve të huaja, nota mesatare minimale 7.

Po sipas këtyre vendimeve, për programet e studimit dyvjeçare, me karakter profesional, për programet në fushën e artit dhe sportit, nuk është detyrim kriteri i notës mesatare 6.5, sipas përcaktimit të mësipërm.

Kreu I

Procesi i Pranimeve në nivel kombëtar

Në nivel kombëtar, gjatë vitit akademik **2024-2025**, u ofruan:

- **593** programe studimi, nga të cilat:
 - **329** nga IAL-të publike;
 - **264** nga IAL-të jopublike.

Programe të studimit dy-vjeçare me karakter profesional u ofruan gjithsej **99**, nga të cilat:

- **51** nga IAL-të publike;
- **42** nga IAL-të jopublike.

Për programet e studimit të ciklit të parë, ato 2 vjeçar me karakter profesional dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë, për kategorinë shqiptarë brenda vendit, për këtë vit akademik, **në tërësi** u ofruan:

- **32177** kuota nga të cilat:
 - **20054** kuota nga IAL-të publike;
 - **12123** kuota nga IAL-të jopublike.

Në programet e studimit të ofruara në ciklin e parë për vitin akademik 2024-2025 **u regjistruan** më shumë studentë se sa në vitin akademik 2023-2024:

Viti akademik	2023-2024	2024-2025
Publik	14062	13872
JoPublik	7217	7674
Totali	21279	21546

Kreu II


Regjistrimet në nivel sistemi shkollimi (IAL publike/jopublike)

Regjistrimet në IAL-të publike dhe jopublike, krahasuar me regjistrimet në total, pasqyrojnë një shpërndarje në përqindje, të paraqitur në **Grafikun 1**, si më poshtë.

IAL-të publike zënë pjesën më të madhe të regjistrimeve **me:**

- **64.36%** të tyre.

Pjesa më e madhe e regjistrimeve të studentëve vazhdon të jetë e orientuar drejt IAL-ve publike.



Grafik 1


Kreu III

Shpërndarja e regjistrimeve në nivel IAL-je

Tabela 1 tregon numrin e studentëve të regjistruar në Institucionet e Arsimit të Lartë, për vitin akademik 2024-2025.

Tabela 1

Universitetet Publike dhe Jopublike	Shpërndarja e regjistrimeve në nivel IAL
UNIVERSITETI I TIRANËS	15.49%
UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU DURRËS	8.27%
UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	7.37%
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	6.43%
UNIVERSITETI ALEKSANDËR XHUVANI ELBASAN	5.81%
UNIVERSITETI PRIVAT ALBANIAN UNIVERSITY	4.88%
UNIVERSITETI LUIGJ GURAKUQI SHKODËR	4.48%
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS	4.18%
UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS	4.03%
UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI VLORË	3.79%
UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPËRISË	2.94%
UNIVERSITETI ALDENT	2.83%
UNIVERSITETI FAN S. NOLI KORÇË	2.63%
UNIVERSITETI BARLETI	2.54%
UNIVERSITETI EPOKA	2.44%
UNIVERSITETI EQEREM ÇABEJ GJIROKASTËR	2.16%
UNIVERSITETI I SPORTEVE I TIRANËS	2.03%
UNIVERSITETI POLIS	1.99%
UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA	1.55%
UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË	1.45%
UNIVERSITETI LUARASI	1.32%
UNIVERSITETI WESTERN BALKANS	1.24%
UNIVERSITY OF NEW YORK TIRANA	1.12%
KOLEGJI UNIVERSITAR I BIZNESIT	1.05%
KOLEGJI UNIVERSITAR INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË	0.97%
KOLEGJI UNIVERSITAR REALD	0.87%
KOLEGJI PROFESIONAL I TIRANËS	0.85%
TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE	0.82%
UNIVERSITETI I ARTEVE I TIRANËS	0.78%
KOLEGJI UNIVERSITAR BEDËR	0.72%
KOLEGJI UNIVERSITAR QIRIAZI	0.71%
AKADEMIA E SIGURISË	0.63%
AKADEMIA IVODENT	0.53%
AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA	0.32%
KOLEGJI PROFESIONAL I LARTE GJERMAN I TEKNOLOGJISE	0.31%
KOLEGJI UNIVERSITAR LOGOS	0.28%
TIRANA ESTHETICS & STYLE SCHOOL	0.19%



Grafik 2

Nga tabela rezulton se, numri më i madh i studentëve të regjistruar i përket:

- **Universitetit të Tiranës** me **15.49%**, i cili gjithashtu ofron edhe numrin më të madh të kuotave, me **4728**, në **39** programe studimi.
- **Universiteti i Durrësit** me **8.27%** të studentëve të regjistruar, i cili vjen i dyti në renditje, për nga numri i kuotave të ofruara, me **2658** të tilla, në **51** programe studimi.


Kreu IV

Regjistrimet sipas kuotave

Për vitin akademik 2024-2025, vetëm 66.92% e totalit të kuotave janë plotësuar me regjistrime.

Janë plotësuar me regjistrime nga:

- IAL-të publike – **69.10%** e kuotave;
- IAL-të jopublike - **63.30%** e kuotave.



Grafik 3

Nisur nga përqindja më e lartë e plotësimit të kuotave në IAL-të publike, mund të themi se pjesa më e madhe e studentëve preferojnë të regjistrohen në këto IAL.

Plotësimi i kuotave me regjistrime për Institucionet e Arsimit të Lartë

Tabela 2 tregon plotësimin e kuotave me studentë të regjistruar për çdo IAL.

Përqindjen më të lartë të plotësimit të kuotave të ofruara në IAL publike e kanë:

- **Akademia e Sigurisë** me 99.33 % të kuotave të plotësuara.
- **Akademia e Forcave të Armatosura**, me 98.57 % të kuotave të plotësuara.
- **Universiteti i Mjekësisë**, me 97.66% % të kuotave të plotësuara.
- **Universiteti Eqerem Çabej Gjirokastrë**, me 76.35% të kuotave të plotësuara.
- **Universiteti Politeknik i Tiranës**, me 75.05% të kuotave të plotësuara.
- **Universiteti i Tiranës**, me 70.54% të kuotave të plotësuara.
- **Universiteti i Sporteve të Tiranës**, me 85.05 %, i cili ka edhe specifikën e zhvillimit të konkurseve të pranimi, sipas disiplinave, ku aplikantët paraqesin aftësi nga ana e përgatitjes sportive

Përqindjen më të lartë të plotësimit të kuotave të ofruara në IAL jopublike e kanë:

- **Akademia Ivodent**, me 100 % të kuotave të plotësuara.
- **Universiteti European I Tiranës**, me 96.76 % të kuotave të plotësuara.

Tabela 2

IAL publike/ jopublike	Kuotat të plotësuara në nivel IAL-je
AKADEMIA IVODENT	100.00%
AKADEMIA E SIGURISË	99.33%
AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA	98.57%
UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	97.66%
UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS	96.76%
KOLEGJI PROFESIONAL I TIRANËS	86.26%
UNIVERSITETI I SPORTEVE I TIRANËS	85.05%
UNIVERSITETI POLIS	83.27%
UNIVERSITETI ALDENT	82.21%
TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE	77.97%
UNIVERSITETI PRIVAT ALBANIAN UNIVERSITY	76.70%
UNIVERSITETI EQEREM ÇABEJ GJIROKASTËR	76.35%
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	75.05%
UNIVERSITETI LUARASI	74.22%
KOLEGJI UNIVERSITAR REALD	73.73%
UNIVERSITETI I TIRANËS	70.54%
UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPËRISË	69.37%
UNIVERSITETI I ARTEVE I TIRANËS	67.89%
KOLEGJI UNIVERSITAR INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË	67.86%
UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU DURRËS	67.01%
UNIVERSITETI EPOKA	64.42%
UNIVERSITETI LUIGJ GURAKUQI SHKODËR	62.68%
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS	60.58%
UNIVERSITETI ALEKSANDËR XHUVANI ELBASAN	60.05%
UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA	57.59%
UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË	56.83%
KOLEGJI UNIVERSITAR I BIZNESIT	56.47%
UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI VLORE	55.78%
UNIVERSITETI FAN S. NOLI KORÇË	54.52%
UNIVERSITY OF NEW YORK TIRANA	47.73%
KOLEGJI UNIVERSITAR BEDËR	47.68%
UNIVERSITETI BARLETI	45.97%
TIRANA ESTHETICS & STYLE SCHOOL	43.16%
UNIVERSITETI WESTERN BALKANS	39.79%
KOLEGJI UNIVERSITAR LOGOS	28.24%
KOLEGJI UNIVERSITAR QIRIAZI	26.84%
KOLEGJI PROFESIONAL I LARTE GJERMAN I TEKNOLOGJISE	24.44%

Kreu V

Procesi i regjistrimeve në nivel program studimi

Në **Tabelën 3** janë paraqitur 4 programet e studimit më të kërkuara.

Tabela 3

Nr	Universiteti	Programi i studimit	Nr i studentëve të regjistruar për program studimi	Kuotat për program studimi	Raporti në % Kuota-Regjistruar
1	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Mjekësi e përgjithshme	436	436	100%
2	UNIVERSITETI I TIRANËS	Financë	440	440	100%
3	UNIVERSITETI I TIRANËS	Infermieri e Përgjithshme	380	380	100%
4	UNIVERSITETI I TIRANËS	Informatikë Ekonomike	240	240	100%
5	UNIVERSITETI I TIRANËS	Informatikë	200	200	100%

Universitetet i kanë plotësuar të gjitha kuotat e miratuara nga MAS.

Kreu VI

Regjistrimet sipas gjinisë dhe urbanizimit

Tabela 5 paraqet regjistrimet në nivel kombëtar, sipas urbanizimit fshat/qytet, sipas gjinisë femra/meshkuj, sipas sistemit publik/jopublik.

Tabela 5

	Studentë të regjistruar total	Në %	Studentë të regjistruar IAL publike	Në %	Studentë të regjistruar IAL jopublike	Në %
Femra	12701	58.95%	8681	68.35%	4020	58.69%
Meshkuj	8845	41.05%	5191	31.65%	3654	41.31%

Bazuar në të dhënat e tabelës së mësipërme rezulton se për vitin akademik 2024-2025, në nivel kombëtar:

- numri i studenteve femra është më i madh, krahasuar me numrin e studentëve meshkuj.


Për IAL-të publike rezulton se:

- **58.95%** janë femra.
- **80.00%** të regjistruarve vijnë nga qytetet.


Për IAL-të jopublike rezulton se:

- **46.93%** janë meshkuj.
- **86.24%** e të regjistruarve vijnë nga qytetet.

Grafikisht shpërndarja e regjistrimeve sipas **gjinisë** paraqitet si në **Grafikët 4 dhe 5**.




Grafik 4




Grafik 5

Paraqitja grafike e regjistrimeve sipas **urbanizimit** paraqitet në **Grafikët 6 dhe 7**.



Grafiku 6



Grafiku 7

Kreu VII

Mesatarja e studentëve të regjistruar në IAL

Për të analizuar cilësinë e studentëve të regjistruar në ciklin e parë, është përdorur si tregues nota mesatare e përlogaritur sipas VKM Nr. 436, datë 03.06.2020 i ndryshuar.

Kështu në nivel kombëtar kemi:

- Nota mesatare e të gjithë të regjistruarve **7.83**.
- Nota mesatare për studentët e regjistruar në IAL publike **7.82**.
- Nota mesatare për studentët e regjistruar në IAL jopublike **7.83**.


Në nivel kombëtar, studentët e regjistruar në IAL jopublike kanë mesatare më të lartë se studentët e regjistruar në IAL publike.

Nga të dhënat e përpunuara rezulton se:

- notën mesatare më të lartë e ka Universiteti i Mjekësisë: **9.08**.
- notën mesatare më të ulët e ka Kolegji Universitar Qiriazi (Jopublik): **6.36**.

Tabela 6

Universitete Publike dhe Jopublike	Numri i studentëve të regjistruar për çdo IAL	Mesatarja sipas VKM për çdo IAL
AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA	69	7.81
AKADEMIA E SIGURISË	149	7.66
AKADEMIA IVODENT	115	7.15
KOLEGJI PROFESIONAL I LARTE GJERMAN I TEKNOLOGJISË	66	6.51
KOLEGJI PROFESIONAL I TIRANËS	182	6.40
KOLEGJI UNIVERSITAR BEDËR	154	7.87
KOLEGJI UNIVERSITAR I BIZNESIT	227	6.62
KOLEGJI UNIVERSITAR INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË	209	8.72
KOLEGJI UNIVERSITAR LOGOS	61	7.58
KOLEGJI UNIVERSITAR QIRIAZI	153	6.36
KOLEGJI UNIVERSITAR REALD	188	7.34
TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE	177	8.45
TIRANA ESTHETICS & STYLE SCHOOL	41	7.14
UNIVERSITETI ALDENT	610	8.07
UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU DURRËS	1781	7.24
UNIVERSITETI ALEKSANDËR XHUVANI ELBASAN	1252	6.92
UNIVERSITETI BARLETI	547	7.27
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS	899	7.45
UNIVERSITETI EPOKA	525	9.08
UNIVERSITETI EQEREM ÇABEJ GJIROKASTËR	465	6.74
UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS	867	7.68
UNIVERSITETI FAN S. NOLI KORÇË	567	7.06
UNIVERSITETI I ARTEVE I TIRANËS	167	7.68
UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	1586	9.08
UNIVERSITETI I SPORTEVE I TIRANËS	438	6.88
UNIVERSITETI I TIRANËS	3335	8.28
UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI VLORE	816	7.48
UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË	312	9.03
UNIVERSITETI LUARASI	285	7.95
UNIVERSITETI LUIGJ GURAKUQI SHKODËR	964	7.44
UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPËRISË	634	7.24
UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA	334	7.87
UNIVERSITETI POLIS	428	8.44
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	1384	8.64
UNIVERSITETI PRIVAT ALBANIAN UNIVERSITY	1050	7.41
UNIVERSITETI WESTERN BALKANS	267	8.67
UNIVERSITY OF NEW YORK TIRANA	242	8.72
Totali	21546	7.83



Grafik 8

Studentët me arritje më të larta në hyrje janë regjistruar në Universitetin e Mjekësisë.

Tabela 7 paraqet 25 programet e studimit të cilat kanë studentë të regjistruar me notën mesatare më të lartë.

Programet e studimit janë paraqitur të renditura sipas notës mesatare në rendin zbritës.

Tabela 7

Nr	Universitet Publike dhe Jopublike	Program Studimi	Numri i studentëve të regjistruar
UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Mjekësi e Përgjithshme	436	9.75
UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Stomatologji	120	9.70
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Inxhinieri Informatike	150	9.69
UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË	Mjekësi (anglisht)	157	9.53
UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Farmaci	108	9.49
UNIVERSITETI WESTERN BALKANS	Inxhinieri Biomjekesore	6	9.44
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Arkitekturë (Arkitekt)	90	9.43
UNIVERSITETI I TIRANËS	Informatikë Ekonomike	240	9.42
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Inxhinieri Ndërtimi	120	9.36
UNIVERSITETI EPOKA	Inxhinieri Softueri	149	9.25
UNIVERSITETI I TIRANËS	Informatikë	200	9.24
UNIVERSITETI EPOKA	Inxhinieri Ndërtimi	28	9.24
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Inxhinieri Elektronike	117	9.14
UNIVERSITETI EPOKA	Inxhinieri Kompjuterike	88	9.10
UNIVERSITETI EPOKA	Inxhinieri Elektronike dhe Komunikim Dixhital	23	9.10
UNIVERSITETI EPOKA	Arkitekturë	57	9.09
UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Teknikë Dentare	35	9.09
UNIVERSITETI WESTERN BALKANS	Mjekesi	91	9.08
UNIVERSITETI EPOKA	Informatikë Ekonomike	89	9.08
UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA	Inteligjence Artificiale	10	9.07
UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË	Mjekësi (Italisht)	5	9.07
UNIVERSITY OF NEW YORK TIRANA	Biznes dhe Tregti Elektronike	6	9.06
UNIVERSITETI EPOKA	Financë Bankë	23	9.05
UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË	Arkitekturë	19	9.04
UNIVERSITY OF NEW YORK TIRANA	Banking dhe Financë e Aplikuar	7	9.04

Bazuar në të dhënat e tabelës së mësipërme, studentët me arritje më të larta janë regjistruar në programin e studimit Mjekësi e Përgjithshme të Universitetit të Mjekësisë të Tiranës.

Kreu VIII

Cilësia e studentëve të regjistruar sipas gjinisë

Tabela 8 paraqet cilësinë e studentëve të regjistruar në nivel kombëtar, sipas gjinisë dhe urbanizimit për IAL publike/jopublike.

Tabela 8

	Studentë të regjistruar total	Nota mesatare sipas VKM	Studentë të regjistruar IAL publike	Nota mesatare sipas VKM në IAL publike	Studentë të regjistruar IAL jopublike	Nota mesatare sipas VKM në IAL jopublike
Femra	12701	8.06	8681	8.03	4050	8.11
Meshkuj	8845	7.50	5191	7.50	3654	7.49

Bazuar në të dhënat e tabelës së mësipërme, në nivel kombëtar:

- femrat që regjistrohen në IAL kanë notë mesatare më të lartë se Meshkujt;
- të njëjtat raporte kemi edhe përsa i takon studentëve të regjistruar në IAL publike dhe në IAL jopublike, ku femrat kanë notë mesatare më të lartë se meshkujt dhe studentët e qytetit kanë notë mesatare më të lartë se ata të fshatit.

Nëse bëjmë një krahasim sipas gjinisë dhe urbanizimit ndërmjet sistemeve IAL publike dhe jopublike rezulton se:

- femrat që regjistrohen në IAL jopublike kanë notë mesatare më të lartë se femrat që regjistrohen në IAL publike.
- meshkujt që regjistrohen në IAL publike kanë notë mesatare më të lartë se meshkujt që regjistrohen në IAL jopublike.

Kreu IX

Shpërndarja e studentëve të regjistruar sipas intervaleve të notës mesatare sipas IAL

Të dhëna mbi shpërndarjen e notës mesatare sipas segmenteve/interval të përcaktuara në nivel kombëtar për IAL publike/ jopublike, në nivel program studimi.


Tabela 9 tregon numrin e studentëve të pranuar në nivel IAL, sipas dendurive të notës mesatare në segmentet e njëpasnjëshëm të paraqitura më poshtë.

Tabela 9

Nr.	Universitetet	4.5-4.99	5-5.49	5.5-5.99	6-6.49	6.5-6.99	7-7.49	7.5-7.99	8-8.49	8.5-8.99	9-9.49	9.5-10	Grand Total
1	AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA					9	13	21	15	9	1	1	69
2	AKADEMIA E SIGURISË					35	31	35	29	12	7		149
3	AKADEMIA IVODENT		3	12	26	14	16	13	19	11	1		115
4	KOLEGJI PROFESIONAL I LARTE GJERMAN I TEKNOLOGJISE		4	13	23	10	7	5	4				66
5	KOLEGJI PROFESIONAL I TIRANËS	1	16	39	65	23	19	10	4	4	1		182
6	KOLEGJI UNIVERSITAR BEDËR		1		16	13	27	28	26	21	17	5	154
7	KOLEGJI UNIVERSITAR I BIZNESIT	2	15	47	59	36	29	16	10	9	2	2	227
8	KOLEGJI UNIVERSITAR INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË					5	3	22	46	52	52	29	209
9	KOLEGJI UNIVERSITAR LOGOS				3	16	12	13	6	9	1	1	61
10	KOLEGJI UNIVERSITAR QIRIAZI		13	45	46	21	13	8	5	1	1		153
11	KOLEGJI UNIVERSITAR REALD		3	11	20	36	43	31	16	15	10	3	188
12	TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE					8	21	23	28	45	36	16	177
13	TIRANA ESTHETICS & STYLE SCHOOL		1	3	7	5	12	6	6	1			41
14	UNIVERSITETI ALDENT			2	23	51	96	97	140	100	78	23	610
15	UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU DURRËS		40	129	276	340	299	270	207	154	49	17	1781

16	UNIVERSITETI ALEKSANDËR XHUVANI ELBASAN	4	128	167	138	221	205	179	106	66	30	8	1252
17	UNIVERSITETI BARLETI		24	58	73	75	87	75	65	50	30	10	547
18	UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS	1	12	31	106	185	149	136	134	95	38	12	899
19	UNIVERSITETI EPOKA					4	11	30	63	91	132	194	525
20	UNIVERSITETI EQEREM ÇABEJ GJIROKASTËR	2	60	71	63	96	71	41	32	14	6	9	465
21	UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS	1	7	29	77	116	159	126	152	99	77	24	867
22	UNIVERSITETI FAN S. NOLI KORÇË	1	33	70	68	115	91	78	55	37	17	2	567
23	UNIVERSITETI I ARTEVE I TIRANËS		1	11	14	18	27	27	25	27	13	4	167
24	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS						33	100	216	309	329	599	1586
25	UNIVERSITETI I SPORTEVE I TIRANËS		4	50	108	96	84	57	26	11	2		438
26	UNIVERSITETI I TIRANËS					263	445	531	675	617	544	260	3335
27	UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI VLORË		11	17	59	175	172	155	111	66	35	15	816
28	UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË					11	14	20	28	31	80	128	312
29	UNIVERSITETI LUARASI					40	50	54	66	46	26	3	285
30	UNIVERSITETI LUIGJ GURAKUQI SHKODËR		15	33	70	206	206	175	131	74	40	14	964
31	UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPËRISË		6	36	71	162	133	93	76	40	12	5	634
32	UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA		2	16	37	32	42	49	42	46	45	23	334
33	UNIVERSITETI POLIS		3	8	17	16	33	36	69	102	92	52	428
34	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS					83	115	144	193	237	332	280	1384
35	UNIVERSITETI PRIVAT ALBANIAN UNIVERSITY	1	4	26	120	220	225	181	141	80	48	4	1050
36	UNIVERSITETI WESTERN BALKANS					16	21	22	36	53	60	59	267
37	UNIVERSITY OF NEW YORK TIRANA					5	16	30	43	37	59	52	242
	Grand Total	13	406	924	1585	2777	3030	2937	3046	2671	2303	1854	21546

SHPËRNDARJA E DËNDURIVE (%) NË SEGMENTET E NOTËS MESATARE (sipas VKM) PËR STUDENTËT E REGJISTRUAR NË NIVEL KOMBËTAR




Grafik 9

Në **grafikun 9** tregohen përqindjet përkatëse për studentët e regjistruar me notë mesatare nga 4.5 deri në 10, të ndarë në njëmbëdhjetë segmente.

Rezulton se:

- **8.6 %** e studentëve të regjistruar në nivel kombëtar kanë notë mesatare në hyrje nga 9.50 në 10.00.
- **54.2%** e studentëve të pranuar e kanë mesataren e notave nga 7 deri në 8.99.



Grafik 10


Nëse i shikojmë shpërndarjet (**Grafiku 10**) sipas sistemit IAL publike,

Rezulton se:

- **8.80%** e të regjistruarve në IAL-të publike janë me notë mesatare nga 9.50 në 10.
- **36.95%** të regjistruarve në IAL-të publike janë me notë mesatare nga 8 në 9.49.

Në **Grafikun 11** tregohet shpërndarja sipas segmenteve të notave mesatare në IAL-të jopublike, sipas të cilit rezulton se:

- **8.25%** e studentëve të regjistruar në IAL-të jopublike kanë notë mesatare nga 9.50-10.
- **37.71%** e studentëve të regjistruar në IAL-të jopublike kanë notë mesatare nga 8 në 9.49.



Grafik 11


Në **Tabelën 10** janë paraqitur programet e studimit me më shumë se 19 studentë, me notë mesatare nga 9.5 deri në 10 të renditura në rendin zbritës.

Tabela 10

Nr	Universitet	Program Studimi	Numri i studentëve të regjistruar me nota mesatare(VKM) 9.50-10
1	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Mjekësi e Përgjithshme	399
2	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Inxhinieri Informatike	134
3	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Stomatologji	119
4	UNIVERSITETI I TIRANËS	Informatikë Ekonomike	113
5	UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË	Mjekësi (anglisht)	98
6	UNIVERSITETI EPOKA	Inxhinieri Softueri	69
7	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Farmaci	47
8	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Arkitekturë (Arkitekt)	43
9	UNIVERSITETI I TIRANËS	Informatikë	41
10	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Inxhinieri Ndërtimi	39
11	UNIVERSITETI EPOKA	Inxhinieri Kompjuterike	36
12	UNIVERSITETI I TIRANËS	Drejtësi	36
13	UNIVERSITETI POLIS	Arkitekturë dhe Dizajn Urban	33
14	UNIVERSITETI I TIRANËS	Financë	31
15	UNIVERSITETI EPOKA	Informatikë Ekonomike	30
16	UNIVERSITETI WESTERN BALKANS	Mjekësi	28
17	KOLEGJI UNIVERSITAR INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË	Inxhinieri Softuerike	21
18	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Inxhinieri Elektronike	21
19	UNIVERSITETI EPOKA	Arkitekturë	20
20	UNIVERSITETI ALDENT	Stomatologji	19

Numrin më të lartë të studentëve, në këtë interval notash, e ka program i studimit **Mjekësi e Përgjithshme** me **399** studentë.

Më poshtë po paraqesim grafikisht shpërndarjen e studentëve më cilësorë nëpër programe studimi për 20 programet me më shumë se 19 studentë të tillë.



Grafik 12

Kreu X

Procesi i pranimit në programet e studimit të fushës mësuesi.

Programet e studimit të ciklit të parë të mësuesisë janë **65** nga **593** programe studimi në total.

Nga këto programe studimi **55** ofrohen nga IAL publike dhe **10** nga IAL jopublike.

Në të tri raundet, për programet e studimit që profilizohen mësuesi janë regjistruar gjithsej 1408 studentë (në 65 programe e studimit).

Regjistrime në nivel kombëtar dhe sistemi shkollimi

Nga numri total i studenteve të regjistruar **21547**, në **593** programe studimi rezulton se **1408** studentë regjistrohen në Mësuesi:

- **6.53%** e të regjistruarve i përkasin programeve që profilizohen në mësuesi.
- **93.47 %** i përkasin të regjistruarve në programet e tjera të studimit.

Tabelat paraqesin numrin e studentëve të regjistruar në programet e mësuesisë për vitin akademik 2024-2025 si dhe krahasimin me vitin 2023-2024.

Viti akademik 2024-2025


Tabela 11

GJITHSEJ MËSUESI	STUDENTË TË REGJISTUAR	NE %
	1408	100%
MËSUESI PUBLIKE	1238	87.93%
MËSUESI JOPUBLIKE	170	12.07%

Viti akademik 2023-2024

GJITHSEJ MËSUESI	STUDENTË TË REGJISTUAR	NE %
	1447	100%
MËSUESI PUBLIKE	1327	91.71%
MËSUESI JOPUBLIKE	120	8.29%

Grafiku 13 paraqet numrin e studentëve të regjistruar në programet e tjera të studimit, në raport me programet e studimit që profilizohen në Mësuesi.




Grafiku 13

Grafiku 14 paraqet në përqindje numrin të regjistruarve në programet që profilizohen në mësuesi, në IAL publike dhe jopublike.

- **87.93%** e të regjistruarve janë në IAL-të publike.
- **12.07 %** në IAL-të jopublike.

Regjistrime në mësuesi Bachelor viti akademik 2023-2024



Grafiku 14

Mesatarja e studentëve të regjistruar në IAL në programet e mësuesisë

Për të analizuar cilësinë e studentëve të regjistruar në ciklin e parë në programet e studimit, të cilat profilizohen në mësuesi, është përdorur si tregues nota mesatare, e përllogaritur sipas VKM Nr. 463, date 03.06.2020. Theksojmë se, kriteri i notës mesatare minimale është 7.5, në profilet Mësuesi, për vitin akademik 2024-2025.

Kështu në nivel kombëtar:

- Nota mesatare e të gjithë të regjistruarve në programet mësuesi **7.91**
- Nota mesatare për studentët e regjistruar në IAL-të publike **7.96**.
- Nota mesatare për studentët e regjistruar në IAL-të jopublike **7.54**.


Në nivel kombëtar, studentët e regjistruar në IAL-të publike në programet e mësuesisë kanë mesatare më të lartë se studentët e regjistruar në IAL-të jopublike.

Nga të dhënat e përpunuara rezulton (Tabela 12, Grafiku 15) se:

- notën mesatare **më të lartë** e ka University of New York Tirana me notë mesatare: 8.41.
- notën mesatare **më të ulët** e ka Kolegji Universitar Logos me notë mesatare 7.22.

UNIVERSITETI	Studente te regjistruar ne Mesuesi	Mesatarja sipas VKM për çdo IAL
UNIVERSITY OF NEW YORK TIRANA	8	8.41
UNIVERSITETI I TIRANËS	599	8.38
UNIVERSITETI BARLETI	17	8.03
KOLEGJI UNIVERSITAR BEDËR	11	7.77
UNIVERSITETI LUIGJ GURAKUQI SHKODËR	188	7.72
UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS	28	7.56
UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU DURRËS	146	7.55
UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI VLORË	104	7.53
UNIVERSITETI EQEREM ÇABEJ GJIROKASTËR	66	7.51
UNIVERSITETI ALEKSANDËR XHUVANI ELBASAN	89	7.42
UNIVERSITETI FAN S. NOLI KORÇË	46	7.40
UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPËRISË	43	7.37
UNIVERSITETI PRIVAT ALBANIAN UNIVERSITY	57	7.37
KOLEGJI UNIVERSITAR LOGOS	6	7.25

Tabela 12



Grafiku 15

Tabela 13 paraqet 10 programet e studimit të mësuesisë, në IAL publike, të cilat kanë studentë të regjistruar me notën mesatare më të lartë.

Programet e studimit janë paraqitur të renditura sipas notës mesatare në rendin zbritës.

Tabela 13

UNIVERSITETI	PROGRAM STUDIMI	NR. i studentëve të regjistruar	Mesatare sipas VKM për çdo program
UNIVERSITETI I TIRANËS	Informatikë	200	9.24
UNIVERSITETI I TIRANËS	Psikologji	110	8.62
UNIVERSITETI LUIGJ GURAKUQI SHKODËR	Informatikë	70	7.91
UNIVERSITETI LUIGJ GURAKUQI SHKODËR	Psikologji	43	7.82
UNIVERSITETI I TIRANËS	Gjuhë - Letërsi	68	7.68
UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU DURRËS	Psikologji	39	7.59
UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU DURRËS	Mësuesi për Arsimin Fillor	50	7.58
UNIVERSITETI I TIRANËS	Sociologji	53	7.44
UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU DURRËS	Mësuesi për Arsim Parashkollor	35	7.41
UNIVERSITETI I TIRANËS	Gjeografi	48	7.37

Studentët më cilësorë janë regjistruar në programin e studimit Informatikë, të Universitetit të Tiranës.

Shpërndarja e studentëve të regjistruar sipas dendurive në segmentet e notës mesatare


Tabela 14 i referohet numrit të studentëve të pranuar në nivel IAL-je, sipas dendurive të notës mesatare, në intervalet e njëpasnjëshme, të paraqitura më poshtë.

Tabela 14

Nr	Universiteti	6.5-6.99	7-7.49	7.5-7.99	8-8.49	8.5-8.99	9-9.49	9.5-10	Totali
1	KOLEGJI UNIVERSITAR BEDËR		4	3	3	1			11
2	KOLEGJI UNIVERSITAR LOGOS	1	4	1					6
3	UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU Durrës	35	39	39	16	14	3		146
4	UNIVERSITETI ALEKSANDËR XHUVANI ELBASAN	33	20	16	9	8	3		89
5	UNIVERSITETI BARLETI	2	3	5	2	2		3	17
6	UNIVERSITETI EQEREM ÇABEJ Gjirokastër	23	20	4	10	3	3	3	66
7	UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS	5	10	5	6	1	1		28
8	UNIVERSITETI FAN S. NOLI KORÇË	18	10	9	5	1	3		46
9	UNIVERSITETI I TIRANËS	59	63	85	93	97	150	52	599
10	UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI Vlorë	37	18	20	13	11	4	1	104
11	UNIVERSITETI LUIGJ GURAKUQI Shkodër	40	47	39	28	18	12	4	188
12	UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPËRISË	19	9	6	4	3	1	1	43
13	UNIVERSITETI PRIVAT ALBANIAN UNIVERSITY	25	10	10	9	2	1		57
14	UNIVERSITY OF NEW YORK TIRANA		1	1	2	2	2		8
	Totali	297	258	243	200	163	183	64	1408

Në nivel kombëtar shpërndarja e notave paraqitet grafikisht në **Grafikun 16**.

Në grafik tregohen përqindjet përkatëse për studentët e regjistruar me notë mesatare nga 7 deri në 10 të ndarë në pesë segmente notash.




Grafiku 16

Rezulton se:

- 4.55 % e studentëve të regjistruar në programet e mësuesisë në nivel kombëtar kanë notë mesatare në hyrje nga 9.50 në 10.
- afërsisht 31.46% e studentëve të regjistruar në programet e mësuesisë në nivel kombëtar kanë notë mesatare në hyrje nga 7.5 në 8.49.

Nëse shikojmë shpërndarjet sipas sistemit IAL publike dhe jopublike në segmente notash, do të kemi paraqitjen grafike si në **Grafikun 17**.




Grafik 17

Rezulton se:

- **4.55%** e të regjistruarve në IAL publike mësuesi janë me notë mesatare nga 9.50 në 10.
- **38.78 %** të regjistruarve në IAL publike mësuesi janë me notë mesatare nga 8 në 9.49.

Në **Grafikun 18** tregohet shpërndarja sipas segmenteve të notës mesatare në IAL jopublike.



Grafik 18

Rezulton se:

- **24.71%** e studentëve të regjistruar në IAL jopublike mësuesi kanë notë mesatare nga 8 në 9.49.

Në **Tabelën 15** janë paraqitur programet e studimit me, me notë mesatare nga 9.5 deri në 10 të renditura në rendin zbritës.


Tabela 15

UNIVERSITETI	PROGRAM STUDIIMI	Numri i studentëve të regjistruar me notë mesatare (VKM) 9.50-10
UNIVERSITETI I TIRANËS	Informatikë	41
UNIVERSITETI I TIRANËS	Psikologji	10
UNIVERSITETI BARLETI	Psikologji	3
UNIVERSITETI EQEREM ÇABEJ GJIROKASTËR	Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek	3
UNIVERSITETI LUIGJ GURAKUQI SHKODËR	Psikologji	2
UNIVERSITETI I TIRANËS	Kimi	1
UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI VLORE	Biologji	1
UNIVERSITETI LUIGJ GURAKUQI SHKODËR	Biologji - Kimi	1
UNIVERSITETI LUIGJ GURAKUQI SHKODËR	Fizikë	1
UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPËRISË	Mesuesi Arsim fillor	1

Rezulton se:

- numrin më të lartë të studentëve, në këtë interval notash, e ka programi i studimit Informatikë në Universitetin e Tiranës me 41 studentë.

Më poshtë po paraqesim grafikisht shpërndarjen nëpër programe studimi të studentëve më cilësorë, të cilat profilizohen në mësuesi.



Grafik 19

Kreu XI

Procesi i pranimit në programet e studimit të gjuhëve të huaja.

Programet e studimit të ciklit të parë të gjuhëve të huaja janë **20** nga **593** programe studimi në total.

Nga këto programe studimi **17** ofrohen nga IAL publike dhe **3** nga IAL jopublike.

Në të tri raundet, në programet e studimit të gjuhëve të huaja janë regjistruar gjithsej **207** studentë (në 16 programe e studimit).

Regjistrime në nivel kombëtar dhe sistemi shkollimi

Nga numri total i studenteve të regjistruar **21546**, në **593** programe studimi rezulton se **484** studentë regjistrohen në programet e gjuhëve të huaja:

- **2.25%** e të regjistruarve i përkasin programeve të studimit në gjuhët e huaja.
- **97.75%** i përkasin të regjistruarve në programet e tjera të studimit.

Tabela 16 paraqet numrin e studentëve të regjistruar në programet e gjuhëve të huaja.

Tabela 16

GJITHSEJ Gjuhë të huaja	Studentë të regjistruar	Në %
	484	100%
Gjuhë të huaja IAL PUBLIKE	463	89.86%
Gjuhë të huaja IAL JOPUBLIKE	21	10.14%

Mesatarja e studentëve të regjistruar në IAL në programet e gjuhëve të huaja

Për të analizuar cilësinë e studentëve të regjistruar në ciklin e parë në programet e studimit të gjuhëve të huaja është përdorur si tregues nota mesatare, e përlogaritur sipas VKM Nr. 436, date 03.06.2020 i ndryshuar. Theksojmë se, kriteri i notës mesatare minimale për këto programe, për vitin akademik 2024-2025, është 6.5.

Në nivel kombëtar kemi:


- nota mesatare e të gjithë të regjistruarve në programet e gjuhëve të huaja **7.79**.

Nga të dhënat e përpunuara rezulton se (Tabela 17 dhe Grafiku 20):

- notën mesatare më të lartë e ka Universiteti Eqrem Cabej Gjirokastrë me notë mesatare: 9.48
- notën mesatare më të ulët e ka Universiteti Aleksandër Xhuvani Elbasan me notë mesatare 7.33

Tabela 17

UNIVERSITETI	studentë të regjistruar në Gjuhët e huaja	Mesatarja sipas VKM për çdo IAL
KOLEGJI UNIVERSITAR LOGOS	1	9.48
UNIVERSITETI EQEREM ÇABEJ GJIROKASTËR	12	8.09
UNIVERSITETI LUIGJ GURAKUQI SHKODËR	37	7.96
UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI VLORË	17	7.86
UNIVERSITETI ALEKSANDËR XHUVANI ELBASAN	11	7.79
UNIVERSITETI I TIRANËS	316	7.79
KOLEGJI UNIVERSITAR BEDËR	11	7.77
UNIVERSITETI FAN S. NOLI KORÇË	14	7.75
UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU DURRËS	56	7.69
UNIVERSITETI PRIVAT ALBANIAN UNIVERSITY	9	7.33



Grafiku 20

Tabela 18 paraqet 10 programet e studimit të gjuhëve të huaja, në IAL Publike, të cilat kanë studentë të regjistruar me notën mesatare më të lartë.

Programet e studimit janë paraqitur të renditura sipas notës mesatare në rendin zbritës.

Tabela 18

UNIVERSITETI	PROGRAM STUDIMI	NR. i studentëve të regjistruar	Mesatare sipas VKM për çdo program
UNIVERSITETI LUIGJ GURAKUQI SHKODËR	Gjuhë Gjermane	4	8.24
UNIVERSITETI EQEREM ÇABEJ GJIROKASTËR	Gjuhë Angleze	12	8.09
UNIVERSITETI LUIGJ GURAKUQI SHKODËR	Gjuhë Angleze	21	7.98
UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI VLORË	Gjuhë Angleze	17	7.86
UNIVERSITETI I TIRANËS	Gjuhë Angleze me profile: "Gjuhë angleze", "Përkthim dhe interpretim", "Studime britanike dhe amerikane"	224	7.85
UNIVERSITETI I TIRANËS	Gjuhë Frënge me profile; "Gjuhë dhe komunikim", "Gjuhë letërsi dhe qytetërim francez", "Përkthim dhe interpretim".	8	7.84
UNIVERSITETI LUIGJ GURAKUQI SHKODËR	Gjuhë Italiane	12	7.82
UNIVERSITETI I TIRANËS	Gjuhë Gjermane me profile; "Gjuhë dhe komunikim", "Gjuhë letërsi dhe qytetërim gjermanishtfolës", "Përkthim dhe interpretim"	30	7.81
UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU DURRËS	Gjuhë Gjermane dhe Angleze	20	7.81
UNIVERSITETI ALEKSANDËR XHUVANI ELBASAN	Gjuhë Angleze	11	7.79

Bazuar në të dhënat e tabelës së mësipërme, studentët më cilësorë janë regjistruar në programin e studimit Universiteti Luigj Gurakuqi Shkodër.

Shpërndarja e studentëve të regjistruar sipas dendurive në segmentet e notës mesatare


Tabela 19 tregon numrin e studentëve të pranuar në nivel IAL-je sipas dendurive të notës mesatare në intervalet e njëpasnjëshëm të paraqitura më poshtë.

Tabela 19

UNIVERSITETI	6.5- 6.99	7- 7.49	7.5- 7.99	8- 8.49	8.5- 8.99	9- 9.49	9.5- 10	Grand Total
KOLEGJI UNIVERSITAR BEDËR		4	3	3	1			11
KOLEGJI UNIVERSITAR LOGOS						1		1
UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU DURRËS	12	12	14	10	7	1		56
UNIVERSITETI ALEKSANDËR XHUVANI ELBASAN		3	4	3	1			11
UNIVERSITETI EQEREM ÇABEJ GJIROKASTËR	1	1	4	3	2		1	12
UNIVERSITETI FAN S. NOLI KORÇË	1	6	3		3	1		14
UNIVERSITETI I TIRANËS	42	78	67	78	38	12	1	316
UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI VLORE	2	4	3	4	4			17
UNIVERSITETI LUIGJ GURAKUQI SHKODËR	3	8	10	9	2	3	2	37
UNIVERSITETI PRIVAT ALBANIAN UNIVERSITY	4	1	3		1			9
Grand Total	65	117	111	110	59	18	4	484

Në nivel kombëtar shpërndarja e notave paraqitet grafikisht si në **Grafikun 21**.

Në grafik tregohen përqindjet përkatëse për studentët e regjistruar me notë mesatare nga 6.5 deri në 10, të ndarë në gjashtë segmente notash.



Grafiku 21

Rezulton se:

- **0.83%** e studentëve të regjistruar në programet e gjuhëve të huaja, në nivel kombëtar, kanë notë mesatare në hyrje nga 9.50 në 10.
- **69.83%** e studentëve të regjistruar në programet e gjuhëve të huaja, në nivel kombëtar, kanë notë mesatare në hyrje nga 7 në 8.49.

-Fund-